

Nga: Dr. Bernard Tahirbegolli, Kordinaror i KosADA

Lënda: Raport i punës i KosADA, për periudhën Janar - Dhjetor 2022

KosADA gjatë vitit 2022 va vazhduar të ushtrij rolin e NADO konform obligimeve të dala nga nënshkrimi i Kodit Botëror për Anti Doping nga Presidenti i Komiteti Olimpik të Kosovës.

Gjatë vitit 2022 KosADA kishte për objektivë ndërtimin e kapaciteteve për të ushtruar me të gjitha aspektet funksionin e një Organizate Anti Doping në nivel vendi.

Si pjesë e programit nacional për anti doping janë realizuar seminarët dhe webinarët edukuese për antidoping duke bashkëpunuar me organizat sportive si në vijim:

KOK, Ekipa e Kosovës në Lojërat Olimpikë Dimërore Beijing 2022– webinar në Zoom.

Federata e Çiklizmit të Kosovës– seminari në Hotel Sirius në Prishtinë.

Federata e Tenisit të Kosovës– webinar në Zoom.

Federata e Hendbollit e Kosovës– webinar Zoom.

Federata e Auto Sporteve të Kosovës– webinar Zoom.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina – seminari në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë.

Federata e Shenjëtarisë Sportive të Kosovës – seminari në Holiday Resort në Sllatinë e Madhe.

Federata e Mundje Krahu e Kosovës – webinar në Zoom.

Federata e Rugbit të Kosovës – seminari në Hotel Trofta në Istog.

Federata e Futbollit e Kosovës -seminari me futbollistët e Kombëtares së Kosovës U17.

KOK, ekipa e Kosovës për lojërat Mesdhetare Oran 2022- webinar në Zoom.

Federata e Futbollit e Kosovës, futbollistet femra të Kombëtares së Kosovës për kategorinë A- seminari në Hotel Emerald.

Federata e Karatesë e Kosovës- seminar në Kolegji AAB, Fushëkosovë

FFK, Klubi i Futbollit Drenica – seminar në shtëpinë e Kulturës në Skenderaj

FFK, përfaqësuesit e klubeve të superliges – seminar në Federata e Futbollit e Kosovës

Federata e Xhudos e Kosovës- seminar në Klubi Ippon Pejë

Federata e Hendbollit e Kosovës- seminar në Prishtinë

Federata e Volejbollit e Kosovës – seminar në Prishtinë

Federata e Badmintonit e Kosovës – seminar në Prishtinë

Në bashkëpunim me Federatën e Pingponut të Kosovës kemi realizuar aktivitet edukues për antidopingun gjatë kampionatit Mbarëkombëtar të Pingponut në Pejë.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të KosADA kemi marr pjesë në:

Workshopi për DCO Central, në Ljubljana, Slloveni

Vizitë studimore tek SLOADO në Ljubljana, Slloveni

Simpoziumi vjetor i WADA në vitin 2022, në Lausanne, Zvicër

Workshopi vjetor për antidoping në Siebersdorf, Austri

Vizitë studimore tek Komisioni Antidoping i Turqisë TDMK në Ankara, Turqi

Gjatë muajit Prill kemi realizuar aktivitete me federatat sportive për të shënuar “Play True Day” duke shpërndarë fllajerët për antidoping dhe duke vendosur posterët me mesazhet kundër dopingut në sport në fushat sportive në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Lipjan, Istog.

Kemi marr pjesë në takimin online të WADA për Dry Blood Sport DBS.

Kemi bërë analizën e riskut dhe planin vjetor për testim në programin nacional antidoping.

Eshtë krijuar Testing Pool dhe Registered Testing Pool me sportistët Kosovar dhe kemi mirëmbajtur llogaritë në ADAMS.

Kemi monitoruar vendndodhjen e sportitëve në TP dhe RTP.

Gjatë vitit 2022 kemi mbledhur 38 mostra të urinës për kontrollë të dopingut. Prej tyre janë testuar 13 sportiste femra dhe 25 sportist meshkuj. 47% e mostrave janë mbledhur jashtë garave (OOC) dhe 53% janë mbledhur gjatë garave.

Kemi themeluar Komisionin për TUE në përbërje nga 5 mjek specialist të lëmive të ndryshme.

Për herë të parë Komisioni për TUE ka lëshur një leje për TUE për një sportist.

Gjatë vitit 2022 për herë të parë kemi bashkëpunuar me një federatë ndërkombëtare për të marr mostra në një organizim sportiv ndërkombëtar në Prishtinë. Kemi mbledhur 8 mostra të urines gjatë kontrollës së dopingut në 2022 FISU University World Cup Handball.

Kemi filluar të përdorim DCO central duke kaluar nga formulartët e letrës në kontrollet e dopingut në paperless përmes tabletëve.

Kemi marr pjesë në grupet punuese të MKRS dhe Kuvendit të Kosovës për hartimin e Ligjit për Anti Dopingun.

Kemi realizuar 4 takime online me Janko Dvorsak nga SLOADO me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të KosADA për testime për kontrollë të dopingut, edukim antidoping, TUE dhe menaxhim të rezultateve.

Kemi realizuar takim me AlbNADO me qëllim të kordinimit të edukimit virtual të sportistëve në platformën ADEL dhe ngritjen e bashkepunimit mes dy vendeve në fushën e antidopingut.

Kemi realizuar takim me përgjegjësit e antidopingut të UEFA.

Kemi realizuar takim me përfaqësuesit për Evropë të International Testing Agency.